



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1220 prot.

Tiranë, më 23. 08. 2021

### V E N D I M

**Nr. 156, datë 23. 08. 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 20, datë 22.02.2021, të F. L., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*<sup>1</sup>”, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Rajonale Berat.

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, shtetasi F. L. në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të tij, Drejtoria Rajonale e ASHK-së Berat, duke e larguar nga puna. Mbështetur në aktet e vëna në dispozicion bashkëngjitur ankesës, F. L. pretendon se ka lidhur marrëdhëniet e punës me ish-ZVRPP Berat (sot Drejtoria Rajonale e ASHK Berat), më datë 29.09.2011, në pozicionin e specialistit në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhëniet me Institucionet. Në këtë pozicion pune ka qëndruar deri më datë 14.05.2019, kur është larguar nga puna me udhërin nr. 634, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.

Gjatë 8 viteve të ushtrimit të detyrës, ankuesi pretendon se ndaj tij nuk është marrë ndonjëherë masë disiplinore.

Në datën 04.12.2018, ai është njoftuar nga ana e punëdhënësit se më datë 11.12.2018, duhet të paraqitet në ambjentet e ZQRPP Tiranë për takim me përfaqësues të punëdhënësit për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punës midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, ku ky i fundit do të parashtronte arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit të lëshuar nga ana e subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, datë 27.01.2021, ankuesi është anëtarë i këtij subjekti dhe ka qënë kandidat për këshilltar në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

Takimi i sipërcituar nuk ishte zhvilluar për shkak se ankuesi nuk ishte paraqitur në takim si rezultat i gjendjes së tij shëndetësore, çka vërtetohet sipas tij me anë të raportit mjekësor që ka qenë në kushtet e paaftësisë deri më datë 15.02.2019. Më datë 14.02.2019, nga ana e punëdhënësit, është marrë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Sipas ankuesit, gjatë kohës që ka qenë i punësuar pranë ish-ZVRPP Berat, ka qenë anëtarë i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, Dega Berat. Angazhimi politik është ekspozuar prej tij, nëpërmjet pjesëmarrjes në takime elektorale dhe çdo aktivitet publik të zhvilluar nga kjo forcë politike. Në zgjedhjet vendore të vitit 2015, ankuesi ka qenë kandidat për këshilltar në Këshillin Bashkiak Berat. Gjithashtu gjatë 10 viteve të fundit, ankuesi thekson se ka marrë pjesë si vëzhgues në zgjedhjet e zhvilluara, si përfaqësues i subjektit politik të sipërcituar.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se largimi i tij nga puna është bërë si “hakmarrje politike”, pasi nuk është evidentuar asnjë shkak i arsyeshem apo i justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Në këtë kuptim, ankuesi kërkon nga Komisioneri, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të bindjeve politike dhe rivendosjen e marrëdhënieve të punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>2</sup>, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

*privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të këtij Ligji, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 347/1 prot., datë 04.03.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues<sup>4</sup> ASHK-së dhe Drejtorisë Rajonale të ASHK-së Berat, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më sipër, ASHK, me anë të shkresës<sup>5</sup> nr. 4653/1 prot., datë 01.04.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...F. L., me urdhrin Nr. 739, datë 29.09.2011 të Kryeregjistruesit është komanduar në detyrë specialist në sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, sot Drejtoria Vendore e ASHK-së Berat.

---

<sup>4</sup> Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
- Kopje e vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit, nëse ka.
- Një kopje e dosjes personale të ankuesit.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit (akti i largimit), nëse ka patur punonjës të tjerë të Drejtorisë Rajonale të ASHK-së Berat, me të cilët janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe kanë pretenduar diskriminim për shkak të bindjeve politike.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit (akti i emërimit), nëse ka patur punonjës të emëruar në pozicionin e specialistit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhëniet me Institucionet në Drejtorinë Rajonale të ASHK Berat.
- Informacion dhe kopje të akteve të emërimit/largimit të punonjësve të Drejtorinë Rajonale të ASHK Berat, gjatë 3 viteve të fundit.

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 347/2 prot., datë 02.04.2021

*Në zbatim të urdhrin të mësipërm është nënshkruar kontrata individuale e punës (me afat të pacaktuar) Nr.ska Prot., datë 29.12.2011, midis F. L. në pozicionin e specialistit në sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhënieve me Institucionet, pranë ZVRPP Berat. Për shkak të ndryshimit të organikës dhe strukturës së Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me urdhrin nr. 33, datë 02.04.2013 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ZRPP”, Kryeregjistruesi ka nënshkruar kontrata të reja pune me punëmarrësit. Konkretisht me F. L. është nënshkruar kontrata e re individuale e punës me Nr. 258 prot., datë 27.06.2013, në pozicionin e specialistit në sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhënieve me Institucionet në ZVRPP Berat. Me urdhrin Nr. 634, datë 14.05.2019 “Për zgjidhjen e justifikuar të kontratës së punës”, F. L. është liruar nga detyra. Ky urdhër mbështetet në shkresën Nr.1549 Prot., datë 14.02.2019 me lëndë “Njoftim mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës”, të ish ZQRPP-së.”.*

Lidhur me procedurën e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, ASHK sqaroi se: “Konkretisht me shkresën Nr. 8246/2 prot., datë 19.11.2018 të ish ZQRPP-së është përgatitur një relacion në lidhje me veprimet e F. L.. Referuar kësaj shkrese: pranë ZQRPP është administruar me Nr. 8246 prot., datë 22.10.2018, shkresa e ish ZVRPP Berat me Nr. 6234 prot., datë 18.10.2018, me objekt “Propozim për marrje mase disiplinore për specialistin F. L.”. Nga Regjistruesja e ish ZVRPP Berat është propozuar marrje e masës disiplinore për specialistin F. L. me arsyetimin se specialisti nuk ka zbatuar urdhrin e Regjistrueses Nr. 1173, datë 08.10.2018 për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 25/201 vol. 27, faqe 4, zk 8503 sipas rekomandimeve të Auditit Financiar të ZQRPP-së. Në lidhje me këtë fakt nga specialisti F. L. është kryer shkelje disiplinore pasi nuk ka zbatuar një urdhër të eprorit si dhe rekomandimet e lëna nga Raporti i Auditit Financiar të ish ZQRPP-së.

Gjithashtu, nga specialisti F. L. nuk janë zbatuar orientimet e dhëna nga ish ZQRPP me shkresën Nr. 6432/3 Prot., datë 25.09.2018 dhe shkresën Nr. 125/5 Prot., datë 21.06.2018 duke mos kryer pasqyrimin e saktë të të dhënave të regjistrimit për të garantuar saktësinë e informacionit në lidhje me ankesën e përsëritur të subjektit “S...” sh.p.k.

Për sa më sipër i është propozuar Kryeregjistruesit: Të marrë masë disiplinore “Lirim nga detyra për specialistin F. L.”.

Në këto kushte nga ana e Kryeregjistruesit ka nisur procedura për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me F. L., procedurë e cila është e detyrueshme të zbatohet në të gjitha rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Një e drejtë e tillë, Kryeregjistruesit i buron nga ligji dhe konkretisht neni 17 i ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (ligji i kohës në fuqi) si dhe të rregullores së brendshme në të cilën përcaktohen detyrat e Kryeregjistruesit, i cili ka të drejtë të emërojë dhe shkarkojë punonjësit e ZVRPP.

*Në rastin konkret marrëdhënia e punës është zgjidhur për shkaqe të justifikuara duke përcaktuar afatin dhe procedurën e përcaktuar shprehimisht në ligj (nenet 141-148 të Kodit të Punës), pasi F. L. ka shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë.*

*Punëdhënësi ka zgjidhur kontratën së punës, për arsye se paditësi ka shkelur detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës me faj të rëndë, nisur nga rëndësia, natyra dhe vazhdimësia e shkeljeve të evindentuara, sipas Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. shkeljet me faj kanë krijuar një situatë të rëndë që sipas parimit të mirëbesimit, nuk lejojnë vijimin e marrëdhënies së punës.*

*Konkretisht me shkresën Nr. 8246/3 prot., datë 21.11.2018 “Njoftim mbi diskutim të marrëdhënieve të punës”, ZQRPP-ja bazuar në nenin 144 pika 1 e Kodit të Punës, i ndryshuar, fton në takim paditësin, për të biseduar mbi marrëdhënien e punës midis tij dhe punëdhënësit.*

*Në përputhje me kërkesat ligjore të Kodit të Punës, në këtë takim përfaqësues të punëdhënësit, parashtrojnë arsyet për të cilat punëdhënësi mendon të ndërpresë marrëdhënien e punës me paditësin F. L..*

*Takimi zyrtar në lidhje mesa më sipër do të mbahej në datë 27.11.2018, në mjediset e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në ish ZQRPP, Tiranë.*

*Takimi midis F. L. dhe përfaqësuesve të punëdhënësit nuk është zhvilluar. Për këtë arsye është mbajtur Procesverbali Nr. Ska Prot., datë 04.12.2018 nga përfaqësues të punëdhënësit ku është konstatuar se F. L. nuk është paraqitur në takimin e datës 27.11.2018, pasi ka marrë njoftimin me vonesë lidhur me takimin, përkatësisht në datë 03.12.2018, vërtetuar me nënshkrimin e librit të protokollit të ZVRPP Berat. Për këto arsye, F. L. i është përcaktuar një datë tjetër takimi me përfaqësuesit e punëdhënësit.*

*F. L. me shkresën Nr. 9251 prot., datë 04.12.2018 të ZQRPP-së, është njoftuar përsëri për diskutim të marrëdhënieve të punës. Në përputhje me kërkesat ligjore, përfaqësuesit e punëdhënësit do të parashtronin arsyet për të cilat punëdhënësi mendon të ndërpresë marrëdhënien e punës me paditësin. Takimi zyrtar në lidhje me sa më sipër do të mbahej në datë 11.12.2018, në mjediset e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, midis përfaqësuesve të Punëdhënësit dhe F. L.. Nga përfaqësuesit e punëdhënësit është mbajtur Procesverbali Nr. ska Prot., datë 13.02.2019, sipas të cilit është konstatuar se paditësi nuk është paraqitur në takim për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë nga data 10.12.2018- 07.02.2019, vërtetuar kjo me kopjet e raporteve mjekësore (4 raporte në total), bashkëlidhur këtij procesverbali.*

*Në këto kushte, në mbështetje të nenit 147 pika 2 e Kodit të Punës, ku citohet “Kur zgjidhja e kontratës bëhet para se punëmarrësi të jetë me paaftësi të përkohshme në punë ose të jetë me pushime të dhëna nga punëdhënësi dhe afati e njoftimit nuk ka përfunduar, ky afat pezullohet për periudhën e kryerjes së shërbimit ushtarak, të paaftësisë së përkohshme në punë ose të pushimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe rifillon pas përfundimit të kësaj periudhe” afati i njoftimit është pezulluar dhe ka rifilluar pas përfundimit të kësaj periudhe.*

*Që prej datës 07.02.2019, F. L. nuk është paraqitur pranë punëdhënësit për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punës dhe nuk ka paraqitur as dokumenta të ligjshme e të rregullta për të justifikuar mosparaqitjen e tij në vendin e punës.*

*Në këto kushte, duke marrë për bazë arsyet e cituara në relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Apelimit me Nr. 8246/2 Prot., datë 19.11.2018, me shkresën Nr.1549 Prot., datë 14.02.2019 të ZQRPP-së, F. L. i njoftohet vendimi për zgjidhjen e kontratës së punës me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.*

*Me urdhrin Nr. 634, datë 14.05.2019 “Për zgjidhjen e justifikuar të kontratës së punës”, paditësi është liruar nga detyra, urdhër i cili mbështetet në shkresën Nr.1549 prot., datë 14.02.2019 me lëndë “Njoftim mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës”, të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të ish ZQRPP-së.*

*Përfundimi i marrëdhënies së punës bazohet në nenin 141 të Kodit të Punës, afati i njoftimit i aplikueshëm për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është tre muaj. Pra, marrëdhëniet e punës midis F. L. dhe ish ZQRPP-së kanë përfunduar në datën 14.05.2019.”*

Sa i përket pretendimeve të ankuesit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike të tij, ASHK sqaroi se: “...është e qartë se nga sa u shpjegua më sipër si propozimi për zgjidhjen e kontratës ashtu edhe vendimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës mes tij dhe punëdhënësit absolutisht nuk është ndikuar nga sa pretendon ankuesi. Ritheksojmë se arsyet e inicimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës për F. L. bazohen tërësisht në mospërmbushjen e detyrave funksionale nga ana e tij, ashtu sikurse është faktuar nga dokumentacioni shoqërues i procedurës së ndjekur në respektim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.

*Në mbështetje të qëndrimit tonë, sjellim në vëmendje se punëdhënësi, në këtë rast ish Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk ka pasur asnjë dijeni për angazhimin politik të ankuesit, dhe si rrjedhojë nuk ka asnjë mundësi të ketë shërbyer si shkak për një “hakmarrje politike” siç e cilëson ankuesi. Në ankesën e tij F. L. thotë se angazhimi i tij politik ka qënë aktiv dhe publik përgjatë gjithë viteve të punësimit dhe nuk përmend asnjë rast të vetëm qoftë edhe sporadik se ky angazhim i ka sjellë probleme në punë me eprorët direkt apo punëdhënësin, përkundrazi ai deklaron se lirisht dhe publikisht ka ushtruar të drejtat e tij kushtetuese pa asnjë pengesë...”*

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar ASHK, vuri në dispozicion:

- kopje të procedurës së ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënies së punës për F. L.;
- kopje të dosjes personale;
- kopje e dokumentacionit për rastin e B. C., e larguar nga detyra si Regjistruese në ish ZVRPP Berat, e cila po ashtu ka pretenduar diskriminim për shkak të bindjeve politike.

2. Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 20, datë 22.02.2021, Komisioneri me shkresën Nr. 347/3 prot., datë 04.05.2021 njoftoi palët në proces për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 18.05.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.

Seanca dëgjimore u zhvillua në prani të ankuesit dhe përfaqësuesve së ASHK<sup>6</sup>-së dhe Drejtorisë Vendore Berat<sup>7</sup>.

Fillimisht palët në proces u informuan lidhur me procedurat e ndjekura nga Komisioneri deri në momentin e realizimit të seancës dëgjimore. Gjithashtu, bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdorej si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit.

Në vijim ankuesi sqaroi ndër të tjera se: *“Largimi im nga puna ka qenë një hakmarrje politike, pasi procedura është kryer në kushte diskriminuuese, pa zbatuar parashikimet ligjore.*

*Në datën 08.10.2018, me urdhërin nr. 1173, datë 08.10.2018, ish Regjistruësja e ish ZVRPP Berat më ka urdhëruar të vendos kufizimin veprimeve mbi një pasuri të paluajtshme të S... shpk. Në datën 10.10.2018, kam paraqitur observacion sipas shkresës me nr. 6047 prot, datë 10.10.2018, duke analizuar dhe sqaruar në mënyrë të detajuar arsyet e moszbatimit të këtij urdhëri, i cili në rastin konkret nuk gjen mbështetje ligjore, dhe se një gjë e tillë nuk përmendet as në raportin e Auditit Financiar të ish ZQRPP Tiranë. Këtë observacion ia kam bërë me dije edhe punëdhënësit, Kryeregjistruësit/ish ZQRPP Tiranë, por që asnjëherë nuk kam marrë përgjigje.*

*Në datën 18.10.2018, me shkresën nr. 6234 prot, ish Regjistruësja e ish ZVRPP Berat ka filluar procedurën për dhënie mase disiplinore ndaj meje, procedurë e cila nuk më është komunikuar, por është bërë në mënyrë të fshehtë. Për të mos u marr vesh prej meje, nëpërmjet punonjësve të tjerë të Protokoll-Arkivës, është kërkuar numër protokolli prej titullares, është zënë numri i protokollit, por nuk është regjistruar informacioni dhe nuk është dorëzuar në arkivë kopja e akteve që duhet të qëndrojë në protokoll arkivën e institucionit. Nëse do të kisha informacion lidhur me këtë procedim disiplinor do të kisha paraqitur observacionin përkatës.*

*Që prej datës 29.09.2011, kur kam filluar punë, e deri në datën 14.05.2019, që jam larguar nga puna, kam qenë Specialist në Sektorin e Burimeve Mbështetëse dhe Marrëdhëniet me*

---

<sup>6</sup> Përfaqësuar nga shtetësja G. M.

<sup>7</sup> Përfaqësuar nga shtetasi P. Q.

*Institucionet. Referuar orientimeve të dhëna nga ish ZQRPP Tiranë, me shkresen nr. 125/5 prot, datë 21.06.2018 dhe nr. 6432 prot, datë 25.09.2018, për trajtimin e ankesës së subjektit "S... sh.p.k", në rastin konkret i përkasin një sektori tjetër dhe konkretisht atij të regjistrimit fillestar. Për këtë arsye, ish Regjistruesja e ish ZVRPP Berat i ka kaluar ato për trajtim specialistit K. T. Ankesës së subjektit "S... sh.p.k" dhe orientimeve të ish ZQRPP Tiranë i është dhënë përgjigje me shkresën me nr. 6432/4-5715/1 prot, të datës 22.10.2018, në të cilat është fshirë emri konceptoi i specialistit K. T. dhe është shënuar (nuk dihet nga kush) emri F. L. dhe pa firmën time.*

*Në datën 03.12.2018, ish Regjistruesja e ish ZVRPP Berat ka nxjerrë urdhërin e brendshëm me nr. 1499, protokolluar me nr. 7026, datë 03.12.2018, sipas të cilit urdhërohem të bëj ndjekjen e praktikës në emër të "S... sh.p.k", praktikë e cila ka qenë në ngarkim të K. T., shkëputur marrëdhëniet financiare më datë 30.11.2018 nga ish ZVRPP Berat me dëshirën e tij. Pra, vetëm me anë të këtij urdhëri, provohet katëcipërisht se, shkresa me nr. 8246/2 prot, datë 19.11.2018 e Sektorit të Kontrollit Tekniko Ligjor pranë ish ZQRPP Tiranë që i ka propozuar Kryeregjistruesit "Lirim nga detyra" për specialistin F. L., nuk qëndron, pasi nga ana e tyre nuk është bërë asnjë lloj verifikimi në lidhje me ato që pasqyrohen në këtë shkresë. Ky sektor nuk ka kryer asnjë lloj procedurë, nuk ka verifikuar asnjë shkresë, ku minimalisht duhej të kërkonte zyrtarisht nga ish ZVRPP Berat kopje të akteve, të njoftonte edhe specialistin ndaj të cilit zhvillohet procedura dhe në përfundim të vijonte me masat përkatëse.*

*Një tjetër fakt që dëshmon qartazi se kemi të bëjmë me një hakmarrje politike është edhe vetë fakti se që prej datës 21.06.2018, kur është dërguar shkresa e parë e llojit "orientime në lidhje me ankesën e subjektit S... Shpk" me nr. 125/5 prot, e deri më sot, orientimet e institucionit epror nuk kanë gjetur zgjidhje, si në kohën kur kam qenë në marrëdhënie pune, po ashtu edhe sot e kësaj dite. Në rast se, nuk kemi të bëjmë me diskriminim ndaj meje, atëherë lind pyetja, çfarë është bërë me subjektin S... sh.p.k? Cili specialist po i trajton ankesat e këtij subjekti dhe orientimet e ASHK Tiranë? Çfarë masash janë marrë pas largimit tim nga puna, në lidhje me specialistin apo specialistët që janë marrë me rastin S... Shpk?*

*Përgjigja është fare e thjeshtë: Nuk është kryer asnjë lloj procedure sipas orientimeve të ASHK Tiranë në lidhje me këtë subjekt, dhe nuk është marrë asnjë lloj mase për asnjë punonjës tjetër që është marrë me këtë rast. Ky rast është përdorur, ndonëse padrejtësisht, vetëm për të më ndëshkuar politikisht."*

*Një rast tjetër për të cilin është ngarkuar ankuesi me përgjegjësi, është moszbatimi i urdhërit të Regjistrueses së ZVRPP Berat për kufizimin e një pasurie të një subjekti debitor ndaj institucionit. Lidhur me këtë rast ankuesi theksoi ndër të tjera se: "Pranë ish ZVRPP-së Berat është kryer një aplikim për kalim pronësie për 2 kontrata shit-blerjeje. Tatimi i kalimit të pronësisë kapte vlerën e 734.000 lekë të reja, që duhet të paguante pala shitëse. Specialista që ka qenë në sportel dhe njëkohësisht kushërira e Regjistrueses, nuk e ka mbajtur këtë detyrim, duke nxjerrë kalimin e pronësisë zero lekë. Pasi ka ardhur Auditi i ish ZQRPP-së, ka konstatuar*



*këtë gabim dhe ka përpiluar një raport, në të cilin citohet: “Masa e zhdëmtimit - t’i kërkohet debitorit brenda afateve”. Në këtë rast se nuk e shlyen debitori të zhdëmtohet nga personi përgjegjës, duke vënë dhe emrin e personit përgjegjës. Nga ana e Regjistrueses nuk u mor asnjë masë për t’ia kërkuar debitorit këtë detyrim dhe as për t’u zhdëmtuar nga personi përgjegjës. Në vijim, Regjistruesja më urdhëron të bëj kufizimin e një pasurie tjetër të debitorit, për ta detyruar të paguajë detyrimin ndaj ish ZVRPP-së Berat. Në këto kushte i jam drejtuar me observacion duke i sqaruar arsyet e moszbatimit të urdhrit, pasi përbënte një shkelje dhe vepër penale njëkohësisht. Për këtë kam vënë në dijeni edhe Kryeregjistruesin, por nuk kam marrë asnjë përgjigje.”*

Në vijim nga ana e përfaqësuesve të ASHK-së, asaj qendrore dhe vendore Berat, u sqarua procedura e ndjekur sa i përket zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin. Ndër të tjera nga ana e tyre u theksua fakti që nuk disponojnë ndonjë shkresë me anë të të cilës ankuesi të jetë vënë në dijeni nga ana e Regjistrueses së ish ZVRPP-së Berat, për procedurën e ndjekur për propozimin e masës disiplinore.

Në përfundim të seancës, ankuesi sqaroi se ka vënë në dispozicion të Rregjistrueses së ish ZVRPP-së Berat, raportet mjeksore, nëpërmjet të cilave ka justifikuar pamundësisë për të qenë pjesë e takimeve të lëna nga punëdhënësi për të diskutuar arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, por nga ana e saj nuk janë përcjellë pranë ish ZQRPP-së. Sipas tij, kjo ka qenë edhe arsyeja që janë zgjidhur marrëdhëniet nga ana e punëdhënësit një ditë përpara se atij t’i përfundonin afatet e raportit mjeksor të fundit, për të cilin pretendon se Regjistruesja e Beratit nuk e ka përcjellë tek ish ZQRPP.

U ra dakord që secila nga palët që ka dokumentacion, prova apo parashtrime të reja lidhur me pretendimet e tyre, t’i depozitojë pranë KMD-së. Gjithashtu, u kërkua informacion nga ASHK, nëse ka patur raste të ngjashme me ankuesin për të cilat mund t’i vinin në dispozicion në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës.

Nga ana e palëve, nuk u depozituan prova apo dokumentacion shtesë lidhur me pretendimet e tyre.

**3.** Në kuadër të shqyrtimit të ankesës F. L., nëpërmjet shkresës datë 18.06.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit, parashtrimet e bëra gjatë seancës dëgjimore, si dhe depozitoi në cilësinë e provës, dokumentacionin lidhur me pretendimet e tij.

**4.** Në vijim, ASHK me anë të e-mailit datë 23.07.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Marrëdhënia e punës midis F. L. dhe Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është zgjidhur për shkak se F. L. ka shkelur detyrimet që rrjedhin nga kontrata individuale e punës. Zgjidhja e justifikuar e kontratës së punës është bazuar në shkeljet e*

*konstatuara nga Sektori Tekniko-Ligjor pranë Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si: moszbatim i urdhrit të eprorit, moszbatim i orientimeve të dhëna nga Auditi i Brendshëm i ish ZQRPP-së, mospasqyrimi i informacionit të saktë për qytetarin nëpërmjet mospasqyrimin të saktë të të dhënave në regjistrin e pasurive.*

*Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka ndjekur dhe respektuar procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës në mbështetje të nenit 144 të Ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*Observacioni i F. L. i bërë me shkresën nr. 6047 prot., datë 10.10.2018 është marrë në konsideratë në qëndrimin e mbajtur nga Sektori Tekniko-Ligjor në ralionin me nr.8246/2 prot., datë 19.11.2018.*

*Për sa i përket faktit nëse ka patur raste të punonjësve të tjerë të larguar në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Berat që kanë pretenduar diskriminimin për shkak të bindjeve politike, ju informojmë se nuk ka pasur raste të tilla të ngjashme.*

*Ashtu sikurse kemi përmendur edhe më parë në qëndrimin tonë, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat për të cilat kemi informacion, F. L. është liruar nga detyra për shkak të mospërbushjes së detyrave të tij funksionale, dhe jo për shkaqet që F. L. ngre në pretendimin e tij. Përgjatë 6 viteve ai e ka ushtruar detyrën e tij i qetë dhe pa asnjë llojë pengese të natyrës diskriminuese.”.*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Nga sa verifikohet nga këqyrja e dokumentacionit të subjektit ankues, siguruar në kuadër të shqyrtimit të ankesës së tij, referuar kronologjisë së ngjarjeve, konstatohet se:

F. L., nëpërmjet Urdhërit për “Komandim në Detyrë” nr. 739, datë 29.09.2011, ka lidhur marrëdhëniet e punës me ish ZQRPP dhe ka nënshkruar Kontratën Individuale të punës, me kohëzgjatje tre mujore, në detyrën e Specialistit. Detyrë të cilën do ta ushtronte në ish Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, sot Drejtoria Vendore e ASHK-së Berat.

Më datë 29.12.2011, ndërmjet ankuesit dhe ish ZQRPP, është nënshkruar kontrata individuale e punës (me afat të pacaktuar), në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhënieve me Institucionet, pranë ish ZVRPP Berat.

Për shkak të ndryshimit të organikës dhe strukturës së Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kryeregjistruesi ka nënshkruar kontratën e re me F. L., me Nr. 258 prot., datë 27.06.2013, në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhënieve me Institucionet në ish ZVRPP Berat.

Me Urdhrin Nr. 1173, datë 08.10.2018, Regjistruesja e ish ZVRPP Berat ka urdhëruar: *“Mbështetur në nenin 20 të Ligjit Nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në Rregulloren e Brendshme të ish ZVRPP-së Nr. 148, datë 08.04.1999, pika 6.2 ku “Regjistruesi përcakton detyrat e punonjësve të zyrës, si dhe në bazë të rekomandimeve të lëna nga Auditit, pika 8, Urdhëroj: F. L. me detyrë specialist në sektorin e shërbimeve mbështetëse, të zbatojë praktikën për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 25/201 regjistruar në volum 27, faqe 4, e llojit godinë, ZK 8503 në pronësi të N. G., deri në shlyerjen e plotë të shumës së tatimit.”.*

Ankuesi pasi është njohur me këtë urdhër dhe nuk e ka zbatuar atë, por, me shkresën Nr. 6047 prot., datë 10.10.2018 me lëndë *“Në përgjigje të Urdhrit Nr. 1173, datë 08.10.2018 të Regjistruesit të ZRPP Berat”*, i është drejtuar Regjistrueses së ish ZVRPP Berat, për dijeni Kryeregjistruesit duke parashtruar se nuk mund të vendos ai kufizime mbi këtë pasuri si dhe duke parashtruar se sipas tij Urdhri për vendosjen e kufizimit Nr. 522, datë 30.04.2018 i Kryeregjistruesit është nxjerrë jashtë afateve të përcaktuara në raport, nuk ka emrin e specialistit që e ka konceptuar atë, bazohet në dispozita ligjore që kanë ndryshuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore, në të nuk jepet asnjë argument se përse kjo pasuri duhet të kufizohet dhe nuk përmban mjetet mbrojtëse të palëve që iu drejtohet. Po kështu ai ka parashtruar se nga Raporti i Auditit të bërë nga grupi i auditit i ish ZQRPP Tiranë, nuk rezulton të jetë ai personi përgjegjës për kryerjen e veprimeve.

Përsa më sipër, ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e punëdhënësit, por me shkresën nr. 6234 prot., datë 18.10.2018 me lëndë *“Propozim për marrje mase disiplinore”*, Regjistruesja e ish ZVRPP Berat i ka propozuar Kryeregjistruesit si vijon: *“...është ushtruar nga ana e ish ZQRPP-së Tiranë Auditimi i Brendshëm për vitin 2017. Në cilësinë e regjistruesit të ish ZVRPP Berat, pasi u njoha me raportin final të auditimit konstatova se është lënë si detyrë mbajtja e diferencës së tatimit për kalimin e pronësisë në vlerën 34105 lekë në kontratën e dhurimit dhe diferencën 702399 lekë në kontratën e shitjes për debitorin N. G.*

*Sa më sipër për plotësimin e rekomandimeve, nga ana e ish regjistruesit të ish ZVRPP Berat është proceduar me urdhërin Nr. 522, datë 30.04.2018, ku është kërkuar vendosja e kufizimit për pasurinë 22/201...ky urdhër nuk është zbatuar.... kam vijuar me urdhërin nr. 1173, datë*

08.10.2018, duke urdhëruar F. L. me detyrë Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të zbatojë vendosjen e kufizimit. Ky specialist me shkresën Nr. 6047 prot., datë 10.10.2018, drejtuar me shkrim Regjistruesit dhe per dijeni Kryeregjistruesit ka refuzuar zbatimin e këtij urdhri. Konstatohet se në kapërcim të kompetencave ky specialist jo vetëm refuzon zbatimin e urdhërit të titullarit, por përdor logon e institucionit si dhe numrin e protokollit për një shkresë personale dhe jo zyrtare...propozoj të merret masë disiplinore “Për moszbatim të urdhrit të eprrorit dhe thyerje të etikës në punë” për F. L....”.

Në vijim, me shkresën nr. 8246/2 prot., datë 19.11.2018, me lëndë: “Relacion për shkresën Nr. 6234 prot, datë 18.10.2018, të ish ZVRPP Berat”, Përgjegjësi i Sektorit Teknik e Ligjor, i është drejtuar Kryeregjistruesit duke i parashtruar: “...Në lidhje me këtë fakt nga specialisti është kryer shkelje disiplinore pasi nuk ka zbatuar një urdhër të eprrorit si dhe rekomandimet e bëra nga Raporti i Auditit Financiar të ish ZQRPP. Gjithashtu, nga specialisti F. L. nuk janë zbatuar orientimet e dhëna nga ish ZQRPP me shkresat nr. 6432/2 prot., datë 25.09.2018 dhe shkresën nr. 125/5 prot., datë 21.06.2018 duke mos kryer pasqyrim të saktë të të dhënave të regjistrimit për të garantuar saktësinë e informacionit në lidhje me ankesën e përsëritur të subjektit “S...” sh.p.k. Sa më sipër i propozojmë Kryeregjistruesit: 1. Të marrë masë disiplinore “Lirim nga detyra” për specialistin F. L.”.

Nga shkresa Nr. 125/5 prot., datë 21.06.2018, rezulton se për subjektin “S...” sh.p.k., ka patur një urdhër refuzimi, konkretisht nr. 444, datë 25.05.2009. Me anë të kësaj shkrese, ish ZQRPP ka konstatuar në përmbajtje të saj se ky kufizim i vendosur nuk qëndron dhe se duhet të rishikohet nga ish ZVRPP Berat ky urdhër, në zbatim të nenit 59 të Ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” duke orientuar ish ZVRPP Berat ta rishqyrtojë edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi “S...” sh.p.k., duke kryer procedurat përkatëse për zgjidhjen e problemit dhe të njoftojë, pasi të vendosë, subjektin si dhe zyrën qendrore.

Rezulton se pas marrjes së kësaj shkrese, nga ana e ish ZVRPP Berat është marrë në shqyrtim dosja e subjektit “S...” sh.p.k. dhe përgjigja e kthyer prej saj citohet në shkresën Nr. 6432/3 prot., datë 25.09.2018, të ish ZQRPP, konkretisht në faqen 2, si vijon: “...Nga ish ZVRPP Berat është argumentuar se subjekti S... shpk është në një proces gjyqësor dhe për këtë fakt nuk mund të trajtohet aplikimi i tij për pajisje me dokument pronësie. Nga ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë,) është ngritur kërkesë padi ku ndër të tjera në objektin e kërkesë padisë kërkohet çregjistrimi i pasurive....”.

Në vijim, nga ish ZQRPP është përpiluar shkresa Nr. 6432/3, datë 25.09.2018, me lëndë “Në lidhje me ankesën e “S...” sh.p.k., drejtuar ish ZVRPP Berat”, shkresë e cila rezulton se nuk është urdhër as vendim. Por, pavaresisht kësaj, në përmbajtje të kësaj shkrese, të nënshkruar nga

zëvendës kryeregjistruesi, është shkruar se ish ZVRPP Berat duhet të rishqyrtoj dokumentacionin dhe të regjistrojë pronar subjektin “S...” sh.p.k., duke mos e pajisur me dokument pronësie dhe duke vendosur kufizim sipas nenit 59 të Ligjit *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas verifikimit të ankesës së bërë nga subjekti “S...” sh.p.k lidhur me praktikën e ndjekur nga ish ZVRPP Berat, nëpërmjet shkresës me nr. 165/2 prot., datë 18.04.2017 i ka rekomanduar subjektit të ndjekë rrugën gjyqësore dhe nuk ka evidentuar asnjë shkelje nga ana e ish ZVRPP Berat.

Po ashtu, dhe Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet shkresës me nr. 6975/2 prot., datë 29.12.2017, lidhur me këtë rast ka shprehur qëndrimin e vet se: *“Ish ZVRPP Berat duhet të vijojë me trajtimin e kërkesës për regjistrim të subjektit “S...” sh.p.k vetëm në rast aplikimi dhe depozitimi të dokumentacionit shtesë nga subjekti i interesuar dhe të ndjekë procesin gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat si palë e tretë, deri sa vendimi të marrë formë të prerë”*.

Nga ish ZVRPP Berat është hartuar shkresa nr. 6432/4 prot., datë 22.10.2018 *“Kthim përgjigje”* drejtuar ish ZQRPP-së, për dijeni administratorit të subjektit “S...” sh.p.k. dhe Ministrit të Drejtësisë. Nga kjo shkresë rezulton se nga ish ZVRPP Berat është përpiluar Projekt Urdhër Refuzimi nr. 10, datë 18.10.2008, ku është propozuar refuzimi i kërkesës për regjistrim, i cili është miratuar me urdhërin nr. 444, datë 24.05.2009 të ish ZQRPP Tiranë. Ky urdhër është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe nga Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, vendime ndaj të cilave shoqëria “S...” sh.p.k. ka ushtruar rekurs në Gjyktën e Lartë. Në këtë kuptim, ish ZVRPP Berat, ka theksuar faktin se nuk mund të vijojë me trajtimin e ankesës së “S...” sh.p.k., deri në përfundim të procesit gjyqësor.

Në shkresën e sipërcituar, evidentohet se në fund të saj është shënuar me shtyp *“konc. K. T.”*, këtij emri i është hequr vizë sipër me stilolaps, dhe krahas tij po me stilolaps është shënuar me shkrim dore *“F. L.”*. Në fund është firmosur nga Regjistruësja e ish ZVRPP Berat.

Me shkresën Nr. 8246/3 prot., datë 21.11.2018 *“Njoftim për diskutim të marrëdhënieve të punës”*, ish ZQRPP i është drejtuar ankuesit duke e ftuar për takim për të biseduar për arsyet pse punëdhënësi mendon të ndërpresë marrëdhëniet e punës, takim i cili do të mbahej në datë 27.11.2018. Kjo shkresë i është njoftuar ankuesit në datë 03.12.2018, për këtë shkak është mbajtur në datë 04.12.2018 procesverbal nga e punëdhënësit ku është parashtruar se: *“...F. L. nuk është paraqitur në takimin e datës 27.11.2018, pasi ka marrë njoftim me vonesë lidhur me takimin, përkatësisht në datë 03.12.2018, vërtetuar me nënshkrim në librin e protokollit të ish ZVRPP Berat. Për këtë arsye F. L. do t'i bëhet një tjetër njoftim duke përcaktuar një datë tjetër takimi”*.

Me shkresën nr. 9251 prot., datë 04.12.2018 “Njoftim për diskutim të marrëdhënieve të punës” është njoftuar ankuesi për tu paraqitur në takim në datë 11.12.2018. Në datë 13.02.2019 është mbajtur procesverbal nga përfaqësuesit e punëdhënësit ku është pasqyruar se: “... *Konstatohet se F. L., nuk u paraqit në takim për shkak të paaftësisë së përkohshme për punë nga data 10.12.2018-07.02.2019, vërtetuar me kopje të raporteve mjeksore (4 raporte ne total), bashkëlidhur këtij procesverbali...*”. Që prej datës 07.02.2019, F. L. nuk është paraqitur pranë punëdhënësit për të diskutuar marrëdhënien e punës mes tij dhe ish ZVRPP-së dhe as nuk rezultoi e provuar se ka depozituar raport mjekësor.

Në vijim, me shkresën nr. 1459 prot., datë 14.02.2019 me lëndë: “Njoftim mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës”, ish ZQRPP, ka njoftuar ankuesin se marrëdhëniet e tij të punës do të përfundojnë në datë 14.05.2019. Në këtë shkresë është parashtruar: “...në vijim të: 1. Shkresës së ish ZVRPP Berat me objekt “Propozim për marrje mase disiplinore”, nr. 6234 prot., datë 18.10.2018; 2. Relacionit të Drejtorise Juridike dhe Apelimit me nr. 8246/2 prot., datë 19.11.2018; 3. Shkresës me nr. 9251 prot., datë 04.12.2018 “Njoftim për diskutim të marrëdhënieve të punës”, 4. Procesverbal të mbajtur nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve me datë 13.02.2019...punëdhënësi ju njofton vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme...”

Me shkresën Urdhër Nr. 634, datë 14.05.2019 “Për zgjidhjen e justifikuar të kontratës së punës”, është urdhëruar: “...mbështetur në shkresën nr. 1549 prot., datë 14.02.2019 me lëndë “Njoftim mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës” Urdhëroj: 1. Zgjidhjen e justifikuar të kontratës së punës së F. L. nga pozicioni Specialist në Sektorin e Regjistrimit Fillestar pranë ish Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat.... 3. Marrëdhëniet financiare i ndërpriten me datë 14.05.2019”.

Sa i përket procedurës së ndjekur nga ana e ish ZQRPP-së, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ankuesi i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila ka pranuar pjesërisht pretendimet e F. L.. Aktualisht, ankuesi ka ankimuar vendimin në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në këtë kuptim, vlerëson se ky është një pretendim që do të trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga informacioni i administruar, zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesit është bërë, për shkak të:

- a) Moszbatimit të orientimeve të dhëna nga ish ZVRPP me shkresën me nr. 6432/3 prot., datë 25.09.2018 dhe me nr.125/5 prot., datë 21.06.2018, lidhur me ankesën e subjektit “S...” sh.p.k;

- b) Moszbatimin e urdhrit të Regjistrueses Nr. 1173, datë 08.10.2018 për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 25/201 vol. 27, faqe 4, zk 8503 sipas rekomandimeve të Auditit Financiar të ish ZQRPP-së.

*Së pari*, nga analizimi i përmbajtjes së relacionit nr. 8246/2 prot., datë 19.11.2018 i ish ZQRPP-së dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës nr. 86 regj., datë 30.07.2020 të B. C., kundër Ministrit të Drejtësisë dhe ish-Kryeregjistruesit të ish ZQRPP, rezulton se:

Ish ZVRPP Berat, pas shqyrtimit të dosjes së subjektit “S...” sh.p.k ka informuar ish ZQRPP, ndër të tjera se: *“Nga ish ZVRPP Berat është argumentuar se subjekti “S...” sh.p.k është në një proces gjyqësor dhe për këtë fakt nuk mund të trajtohet aplikimi i tij për pajisje me dokument pronësie. Nga ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është ngritur kërkesë padi lidhur me shqyrtimin e kësaj çështjeje”*.

Regjistruesja e ish ZVRPP Berat, gjatë shqyrtimit të ankesës së saj pranë KMD-së ka pretenduar se: *“...qëndrimi i ish ZVRPP Berat lidhur me trajtimin e kësaj çështjeje është i drejtë dhe tërësisht ligjor, fakt i mbështetur ky edhe nga verifikimi i bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili, pas verifikimit të ankesës së bërë nga subjekti “S...” sh.p.k lidhur me praktikën e ndjekur nga ish ZVRPP Berat, nëpërmjet shkresës me nr.165/2 prot., datë 18.04.2017 i ka rekomanduar subjektit të ndjekë rrugën gjyqësore dhe nuk ka evidentuar asnjë shkelje nga ana e ish ZVRPP Berat”*.

Përsa më sipër, Regjistruesja e ish ZVRPP-së Berat, ka qenë në dijeni të faktit që trajtimi i kërkesës për regjistrim të subjektit “S...” sh.p.k., bëhet vetëm në rast aplikimi dhe depozitimi të dokumentacionit shtesë nga subjekti i interesuar, si dhe kur vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë. Pra, pa përfunduar procesi i plotë gjyqësor dhe pa marrë vendimi formë të prerë, ish ZVRPP Berat nuk mund të ndjekë hapat për regjistrimin e subjektit “S...” sh.p.k.

Megjithatë, edhe pse ka qenë në dijeni të faktit të sipërcituar, me Urdhërin e Brendshëm nr. 1499, protokolluar me nr. 7026, datë 03.12.2018, ka urdhëruar: *“F. L., me detyrë specialist në sektorin e shërbimeve mbështetëse, të bëjë ndjekjen e praktikës në emër të ‘S...” sh.p.k., prantikë e cila ka qenë në ngarkim të K. T. (shkëputur marrëdhëniet financiare në 30.11.2018 nga ish ZVRPP Berat me dëshirën e tij)”*.

Pra, edhe pse Regjistruesja e ish ZVRPP-së Berat ka qenë në dijeni të faktit se ankesa e subjektit “S...” sh.p.k., nuk mund të trajtohej nga ky institucion, ia ka ngarkuar F. L., pasi i ka kthyer përgjigje subjektit, Kryeregjistruesit dhe Ministrit të Drejtësisë me shkresat e sipërcituara.

Së dyti, lidhur me moszbatimin e urdhrit të Regjistrueses Nr. 1173, datë 08.10.2018 për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 25/201 vol. 27, faqe 4, zk 8503 sipas rekomandimeve të Auditit Financiar të ish ZQRPP-së, Komisioneri vëren se:

Nga informacioni i administruar, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të ish ZQRPP-së, gjatë auditimit të kryer në ish ZVRPP Berat, ka konstatuar një diferencë në tarifën e shërbimeve, si dhe në llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit. Për këtë ka rekomanduar Regjistruesin e ish ZVRPP Berat, të nxjerrë urdhrin e brendshëm dhe të ndjekë zbatimin e tij për arkëtimin e këtyre diferencave brenda muajit mars 2018. Gjithashtu, ka përcaktuar në Raportin e Auditit se mbas kalimit të afatit (mars 2018), të kryhet zhdëmtimi nga personat përgjegjës.

Ankuesi, me shkresën nr. 6047 prot., datë 10.10.2018, i është drejtuar Regjistrueses së ish ZVRPP Berat, për dijeni Kryeregjistruesit duke parashtruar se nuk mund të vendos ai kufizime mbi këtë pasuri, pasi përbën një shkelje ligjore. Pavarësisht kësaj, nga ana e tyre nuk është ndërmarrë asnjë hap për të analizuar nëse F. L. ka të drejtë në ato që ka parashtruar ose jo.

Përsa më sipër, edhe pse ishin tejkaluar afatet e përcaktuara nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të ish ZQRPP-së, Regjistruesja e ish ZVRPP-së nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për arkëtimin e këtyre detyrimeve, si dhe nuk rezultoi të ishte ngarkuar me përgjegjësi asnjë nga punonjësit të cilët kishin kryer shkeljen e konstatuar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të ish ZQRPP-së.

Në këtë kuptim, edhe pse ankuesi i ka parashtruar arsyet ligjore mbi moszbatimin e Urdhrit Nr. 1173, datë 08.10.2018, Rregjistruesja e ish ZVRPP Berat, pa ndërmarrë asnjë hap për të informuar ankuesin, me shkresën nr. 6234 prot., datë 18.10.2018, i ka propozuar Kryeregjistruesit marrje mase disiplinore ndaj F. L.

Përsa i takon procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masës disiplinore të lirimit nga detyra të ankuesit, Komisioneri gjykon se, nga ana e ish ZQRPP-së dhe ish ZVRPP-së Berat nuk u sollën prova dhe dokumentacion që të mund të provonin apo përligjinin faktin se punëdhënësi, kishte ndjekur dhe zbatuar procedurën e rregullt ligjore lidhur me të drejtën e ankuesit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur efektivisht.

Dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t'i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës, si dhe për faktin se masat disiplinore më të lehta parashkruhen me kalimin e afateve të caktuara ligjore.



Në nenin 8 të Kontratës Individuale të Punës së ankuesit, lidhur me ish ZQRPP-në, ku parashikohen rastet e përfundimit të saj, përcaktohet se: *“Punëdhënësi jep masa disiplinore ndaj punëmarrësit kur ai shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehët dhe në varësi të shkeljes së kryer punëdhënësi jep masë disiplinore sipas rregullores së brendshme, si më poshtë:*

*Vërejtje*

*Vërejtje me shkrim*

*Vërejtje me paralajmërim.*

*Në zbatim të nenit 153, Kodit të Punës, punëdhënësi mund të zgjidhë në çdo kohë dhe menjëherë kontratën e punës kur ka shkaqe të justifikuara. Do të konsiderohen shkaqe të justifikuara në ngarkim të punëdhënësit rastet kur ai shkel detyrimet kontraktuale në mënyrë të përsëritur me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit dhe konkretisht:*

*Nuk kryen detyrat apo nuk respekton në mënyrë të përsëritur afatet e caktuara për kryerjen e detyrave me gjithë paralajmërimin e punëdhënësit.*

*Thyen disiplinën në punë në mënyrë të përsëritur me gjithë paralajmërimet e punëdhënësit.*

*Nuk zbaton në mënyrë të përsëritur rregulloren e brendshme për funksionimin e marrëdhënieve të punës të vendosura dhe të parashikuara në këtë kontratë.*

*Kryen punë apo veprimtari të cilat çënojnë interesin e detyrës përkatëse ose që pengojnë përmbushjen e saj.*

*Dhe të gjitha kushtet e tjera të punës që përcaktohen në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.”*

Referuar në provat e administruara dhe në parashikimet e Kontratës Individuale të Punës, arsytimi i ish ZVRPP-së Berat, për propozimin për masë disiplinore, dhe ish ZQRPP-së për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nuk gjejnë mbështetje në asnjë nga shkaqet e justifikuara të parashikuara më lart. Në asnjë rast nuk u evidentua se ankuesi në mënyrë të përsëritur ka shkelur detyrimet kontraktuale me punëdhënësin apo të jëtë paralajmëruar ndonjëherë prej tij për shkelje të tjera.

Nëse procedura e njoftimit apo e masës disiplinore do të respektohet, atëherë pa diskutim që punëdhënësi ka të drejtë ta përshkallëzojë dhënien e masës deri në ekstremin e saj. Në të kundërt, nëse punëdhënësi nuk e provon këtë gjë, atëherë ai mund të abuzojë me preteksin e shkeljes së disiplinës për të pushuar nga puna çdo punëmarrës. Në këtë kuptim, masa e marrë për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nuk gjen një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Gjithashtu, Komisioneri gjykon se nga ana e ish ZQRPP-së dhe ish ZVRPP-së Berat është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur efektivisht ndaj shkeljeve të konstatuara në shkresën nr. 8246/2 prot., datë 19.11.2018 të ish-Kryeregjistruesit, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e ish ZQRPP-së.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Berat jo vetëm që nuk dhanë shpjegim objektiv dhe të justifikueshëm, por shpjegimet e dhëna prej tyre, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Në përfundim të provave të administruara, Komisioneri konstaton se:

- Ankuesi është ngarkuar me përgjegjësi lidhur me moszbatimin e orientimeve të dhëna nga ish ZVRPP me shkresën me nr. 6432/3 prot., datë 25.09.2018 dhe me nr.125/5 prot., datë 21.06.2018, sa i përket ankesës së subjektit “S...” sh.p.k., ndërkohë që për këtë ishte ngarkuar punonjësi K. T.;
- Edhe pse për zbatimin e orientimeve të ish ZVRPP, lidhur me ankesën e subjektit “S...” sh.p.k., ishte ngarkuar punonjësi K. T., ndaj tij nuk ishte propozuar asnjë masë disiplinore, për moszbatim të urdhrave të Regjistruetit, por vetëm ndaj ankuesit;
- Pavarësisht se Regjistruetja e ish ZVRPP-së Berat, ishte në dijeni të faktit që nuk mund të zbatonte orientimet e dhëna nga ish ZVRPP, lidhur me ankesën e subjektit “S...” sh.p.k., ia ngarkon ankuesit zbatimin e tyre rreth 2 (dy) muaj pasi i kishte bërë propozimin për masë disiplinore;
- Ankuesi është ngarkuar me përgjegjësi lidhur me moszbatimin e urdhrin të Regjistruetes Nr. 1173, datë 08.10.2018 për vendosjen e kufizimit mbi pasurinë nr. 25/201 vol. 27, faqe 4, zk 8503 sipas rekomandimeve të Auditit Financiar të ish ZQRPP-së, ndërkohë që përgjegjës për shkeljen e kryer ishte një punonjës tjetër;
- Pavarësisht faktit që ankuesi, kishte paraqitur observacionet sa i përket pamundësisë së zbatimit të urdhrin të Regjistruetes për kufizimin e pasurisë 25/201 vol., nga ana e ish ZQRPP-së dhe ish ZVRPP-së Berat, nuk u morën në konsideratë për t’u analizuar.

Përsa më sipër, për dhënien një mase disiplinore, duhet ndjekur një rend kronologjik, fillimisht konstatohen shkeljet e bëra nga punëmarrësi e më pas, referuar tyre punëdhënësi propozon apo merr masën. Në rastin konkret, në një prej shkeljeve të pretenduara, është propozuar fillimisht masa disiplinore e më pas, është konstatuar shkelja e ankuesit.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Berat. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi F. L. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Berat, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>8</sup>, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ankuesi ka pretenduar në thelb, trajtimin diskriminues, nga ana e ZQRPP dhe ZVRPP Berat, për shkak të bindjeve politike të tij. Në mbështetje të shkakut të pretenduar, ankuesi ka depozituar në cilësinë e provës:

- Vërtetimin datë 27.01.2021, me anë të të cilit provon faktin se është anëtarë i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, prej vitit 2015;

---

<sup>8</sup> “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

- Autorimin “Për vëzhguesit për subjektet zgjedhore”, Nr. 17, datë 21.06.2015, lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me anë të të cilit provohet që ankuesi ka qenë i akredituar si vëzhgues në zgjedhjet e Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2015;
- Kontributet e vërtetuara me anë të pagesave të kryera në bankë, sa i përket kuotës së anëtarësisë në LSI;
- Dokument të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në të cilin konstatohet se ankuesi ka qenë kandidat për anëtarë të Këshillit Bashkiak Berat, në zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore të vitit 2015.

Në këtë kuptim shkak i bindjeve politike të pretenduar nga ankuesi, konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që provojnë se ai e mbart këtë shkak.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.<sup>9</sup>

Gjykata Kushtetuese<sup>10</sup>, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.*

*Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.*

<sup>9</sup> Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

*E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.*

***Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.***

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga Kodi i Punës.

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene këtë akt rregullator, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”.* Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore<sup>11</sup>”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.*

Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>12</sup> *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Konventa e përkufizon diskriminimin si - *çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.*

*Karta Sociale Europiane<sup>13</sup>* në nenin 1, pika 2, parashikon: *“ Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...”* Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim<sup>14</sup>.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për cilindo nga shkaqet e mbrojtura.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë.

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme<sup>15</sup>.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

<sup>12</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>13</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>14</sup> Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, prg 30.*

<sup>15</sup> Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*. Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës, ndalohej çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në bazë të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS<sup>16</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Bazuar në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: “*10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat*

---

<sup>16</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

*mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara*”<sup>17</sup>.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, për shkak se subjekti kundër të cilit pretendohet diskriminim posedon informacionin e nevojshëm, për të provuar të kundërtën ligji i mosdiskriminimit lejon që barra e provës të ndahet me këtë subjekt (zhvendosja e barrës së provës). Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se **ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues**. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

<sup>17</sup> GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Ruisisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.



- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse diskriminuesi i pretenduar nuk është në gjendje të provojë njëherë nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>18</sup>

Sa i takon rastit në fjalë, KMD bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe ato që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës ka arritur në përfundimin që kemi të bëjmë me një trajtim të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të tij, nga ana e ish ZQRPP-së dhe ish ZVRPP-së Berat. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtar i lëvizjes Socialiste për Integrim, duke provuar në këtë mënyrë bindjet e tij politike.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Bindjet politike përbëjnë një të dhënë sensitive të personit dhe shpesh herë punëdhënësi mbrohet me faktin se ai e ka të ndaluar që të mbledhë të dhëna për bindjet politike të punëmarrësve, e për rrjedhojë ai nuk ka si të ketë dijeni për bindjet politike të punëmarrësve të vet. Në lidhje me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, provat rrethore mund të hedhin poshtë pretendimin e punëdhënësit se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit dhe për këtë arsye të provohet se punëdhënësi ka patur dijeni. Disa fakte dhe prova që mbështesin dijeninë për bindjet politike të ankuesit janë si më poshtë:

Ankuesi gjatë trajtimit të ankesës ka parashtruar se, fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato Regjistrueses së ish ZVRPP Berat, kanë sjellë për pasojë edhe propozimin për marrjen e masës disiplinore ndaj tij. Pavarësisht këtij fakti, ankuesi nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë fakt apo argument për të vërtetuar pretendimin e tij sa i përket bindjeve politike të Regjistrueses së ish ZVRPP Berat. Gjithashtu, edhe nga hulumtimet e bëra nga Komisioneri nuk u arrit të siguroheshin informacione apo prova se, Regjistruesja e ish ZVRPP Berat ka shfaqur një aktivitet të njohur politik apo bën pjesë në një prej subjekteve politike në vend.

Sa i përket rastit të Kryeregjistruesit, Komisioneri, referuar informacionit<sup>19</sup> të administruar, konstaton se z. V. P., në zgjedhjet për Organet e Pushtetit Vendor të vitit 2019, ka qenë kandidat i propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Lidhur me aktivitetin politik të Kryeregjistruesit përpara zgjedhjeve të vitit 2019, nuk rezulton e provuar që ai të ketë shfaqur bindjet e tij politike apo të ketë qenë pjesë e ndonjë subjekti politik.

Referuar rasteve të tjera<sup>20</sup> të trajtuara nga Komisioneri, është interpretuar fakti që në kontekstin social-kulturor shqiptar në qytetet me një popullsi të vogël në numër, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri tjetrin dhe dijeni lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i

<sup>18</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>19</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/profil-v-p-e-nisi-karrieren-ne-kohen-e-berishes-ishte-i-pajisur-me-certifikate-sigurie>  
<http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/06/V.-P.-1.pdf>

<sup>20</sup> Vendimi Nr. 144, datë 26. 10. 2020

funkcioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

Në rastin konkret, ish ZVRPP Berat, ka qenë institucion nën varësinë e ish ZQRPP-së, pra, ish ZQRPP ka patur cilësinë e punëdhënësit për të gjithë punonjësit e ish ZVRPP-ve. Duke marrë në konsideratë faktin, që ish ZQRPP, ka patur një numër të konsiderueshëm punonjësish në të gjithë territorin e Shqipërisë, jo detyrimisht në cilësinë e punëdhënësit Kryeregjistruesi mund të ketë dijeni lidhur me bindjet politike të punonjësve të tij.

Pra, përse u analizua më sipër, Komisioneri nuk arrin të konstatojë faktin që punëdhënësi i subjektit ankues, ish ZQRPP, apo ish ZVRPP Berat në cilësinë e subjektit i cili ka iniciuar procedurën për propozimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, kenë patur aktivitet politik të apo bindje të kundërta me F. L., siç pretendohet prej tij në ankesë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pala ankuese nuk arriti të krijojë një prezumim të diskriminimit, pra një diskriminim *prima facie*. Pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë, të pabarabartë apo të paligjshëm ndaj ankuesit, nga ana e ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Berat, dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar bindjen dhe për të prezumuar se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesi është si rezultat i posedimit të këtij shkakut dhe se në mungesë të tij ankuesi do të ishte trajtuar ndryshe. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues me pretendimin për diskriminim, në të drejtën për punësim, për shkaqet e analizuar më sipër, nga ana e ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Berat është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që punëdhënësi të jenë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, F. L., për shkak të bindjeve politike të tij, nga ana e ish Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Rasurive të Paluajtshme dhe ish Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindja politike)

(Fusha: Punësim)